

VENDIM
Nr.1388, datë 17.10.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE
SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të 2 (dy) autokolonave ushtarake slovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 27 tetor 2008, të përbëra nga:

a) Autokolona e parë, 1 (një) automjet dhe 6 trupa. Itinerari i lëvizjes, Qafë-Thanë - Porti i Durrësit.

b) Autokolona e dytë, 3 (tri) automjete dhe 8 (tetë) trupa. Itinerari i lëvizjes, Porti i Durrësit - Qafë-Thanë.

2. Lejimin e kalimit transit të 2 (dy) autokolonave ushtarake slovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 30 tetor 2008, të përbëra nga:

a) Autokolona e parë, 4 (katër) automjete dhe 14 (katërmëdhjetë) trupa. Itinerari i lëvizjes Qafë-Thanë - Porti i Durrësit.

b) Autokolona e dytë, 1 (një) automjet dhe 6 (gjashtë) trupa. Itinerari i lëvizjes, Porti i Durrësit - Qafë-Thanë.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 27 tetor 2008, për autokolonën e parë, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit, dhe për autokolonën e dytë, pika e hyrjes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 30 tetor 2008, për autokolonën e parë, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit dhe për autokolonën e dytë, pika e hyrjes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake slovene, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha